



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 88 Prot

Tiranë, më 21.01.2022

V E N D I M

Nr.9, datë 21.01.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ të kërkesës së paraqitur nga nëpunësja *** , me objekt kundërshtimin e zgjidhjes së kontratës së punës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 1984/1, datë 3.12.2021, është përcjellë për kompetencë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kërkesa e nëpunëses doganore ***** , protokolluar me nr. 1062, datë 6.12.2021, për shkak se objekti i ankesës së saj ka të bëjë me zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Në kërkesën e saj, punonjësja në fjalë, ngre pretendimin se, pozicioni i saj i punës, për të cilin ka konkurrar dhe është shpallur fituese, ka qenë *Komandant Grupi, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria e Antikontrabandës*, por megjithatë, nga momenti i fillimit të marrëdhënies së punës (datë 2.9.2021) deri në datën 23.11.2021, kur i është

komunikuar zgjidhja e kontratës së punës, ajo është pozicionuar nga eprori, me detyrën si inspektore, gjatë kryerjes të së cilës nuk ka patur asnjë vërejtje me shkrim apo me gojë, që do të mund të diktonte largimin e saj nga puna.

Nga përmbajtja e kërkesës, si dhe akteve që e shoqërojnë atë, evidentohet fakti se pretendimi ngrihet për një marrëdhënie pune të lidhur nëpërmjet kontratës individuale të punës me nr.15561, datë 1.9.2021, ndërmjet punonjësës ***** dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për pozicionin e punës “Komandant Grupi, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria e Antikontrabandës”, i cili, sipas legjislacionit doganor, nuk është pjesë e shërbimit civil.

Nga përmbajtja e legjislacionit të shërbimit civil dhe atij doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil (*shih, nenin 13, pika 1, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar, ku parashikohet se, punonjësit e administratës doganore, me përjashtim të punonjësve administrativë, dhe VKM nr.142, datë 12.3.2014, lidhja nr. 1, numër rendor 39*), por me Vendimin nr. 9, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, ka ndryshuar regjimi juridik i marrëdhënies së punësimit për disa prej drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku përfshihet edhe Drejtoria e Antikontrabandës, në të cilën është punësuar ankuesja.

Konkretisht, në pikën 6, të këtij vendimi është përcaktuar shprehimisht:

*“Në fund të pikës 29, të pjesës VII, (të VKM nr. 921, datë 29.12.2014) shtohet paragrafi, si më poshtë vijon: Në përputhje me shkronjën “h”, të paragrafit të parë të nenit 2, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe pikën 4, të nenit 7, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, punonjësit e Drejtorisë së Hetimit, Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Drejtorisë Antitrafik, që kanë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, trajtohen në përputhje me **Kodin e punës ...**”.*

Bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyr, kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në rastin konkret, punësimi i kërkueses ***** nëpërmjet kontratës individuale të punës me nr.15561, datë 1.9.2021, në pozicionin Komandant Grupi, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria e Antikontrabandës, i cili nuk përfshihet në fushën e shërbimit civil, përcakton faktin që mosmarrëveshja e lindur në këtë rast, nuk mund të jetë

objekt hetimi apo vlerësimi nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, prandaj ky proces verifikimi duhet të ndërpritet dhe çështja të arkivohet. Pretendimet e ankueses në fjalë duhet të zgjidhen vetëm në organet gjyqësore, në bazë të Kodit të Punës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 14, bazuar në shkronjën “h”, të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ mbi informacionin e marrë nga kërkesa e nëpunëses *****, e cila kundërshton zgjidhjen e kontratës së punës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pasi çështja nuk hyn në juridiksionin e shqyrtimit nga Komisioneri dhe arkivimin e saj.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha